1007

089/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr 2831/1 **Prot.** **Tiranë, më** 23/06/ **2017**

Lënda: ***Kthim përgjigje***

Drejtuar: **Z. Dorian MATLIJA**

Drejtor Ekzekutiv
Qendra "Res Republika"

Adresa : Blv."Gjergj Fishta", Nd.24, H 3, Ap. 44 Tiranë
Email : dorian.matlija@gmail.com

I nderuar Z. MATLIJA,

Bazuar në shkresën Tuaj Nr. *089/17* Prot., me lëndë : *"Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit"*, ardhur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së me Nr. Prot. 2831, datë 21.06.2017, referuar kerkesës së një qytetari për informim, Ju sqarojmë si më poshtë :

- Në lidhje me pyetjet Tuaja numër **1, 2** dhe **4** ku kërkohet :

  "**1.** Cila është origjina e miellit dhe drithrave që konsumojnë qytetarët shqiptarë?;
  2. Nga cilat zona importohet mielli dhe drithërat që konsumojmë në Shqipëri?"; si dhe
  4. "A konsumohet ne Shqipëri miell /drithëra me origjinë nga Ukraina",

Ju informojmë:

Produktet ushqimore "Mielli dhe drithëra" që konsumohen në Republikën e Shqipërisë janë me origjinë/importuar nga shtete të ndryshme. Më poshtë po Ju pasqyrojmë një informacion më të detajuar për periudhën nga viti 2015 deri më vitin 2017:

Adresa: Rruga "Myslym Keta", Tufine, Tirane
Tel: ++355 4 22 56 137
Fax: ++355 4 22 52 658

- Për vitin 2015 këto produkte janë importuar nga: Greqia, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Italia, Maqedonia, Bullgaria, Turqia, Hungaria, Rusia, Kroacia.
- Për vitin 2016 këto produkte janë importuar nga: Greqia, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Italia, Maqedonia, Bullgaria, Turqia, Austria, Franca, Rusia.
- Për vitin 2017 këto produkte janë importuar nga: Greqia, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Italia, Maqedonia, Bullgaria, Hungaria, Rusia.

Për sa i përket importeve nga Ukraina, Ju bëjmë me dije se për vitin 2015, 2016 dhe 2017, në Shqipëri nuk ka patur anjë import të produktit ushqimor "miell" apo "drithëra".

- Në lidhje me pyetjet Tuaja numër **3** dhe **7** ku kërkohet:

  "3. Sa te shpeshta jane kontrollet e kryera mbi keto produkte (mielli dhe dritherat)?; dhe
  "7. A harton AKU raporte vjetore mbi kontrollet dhe cilësinë e ushqimeve në përgjithësi dhe miellit/dritherave në veçanti ?",

Ju informojmë :

AKU kryen kontrolle zyrtare në të gjitha qarqet, sipas *"Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë risku dhe marrjes së mostrave për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore, si dhe Planit të Marrjes së Mostrave në PIK"*, (plan ky i miratuar nga Ministri i MBZHRAU), i cili është i hartuar, sipas kategorizimit të OBU që prodhojnë, përpunojnë dhe shpërndajnë ushqime me origjinë shtazore dhe jo shtazore, si dhe klasifikimit të riskut të ndarë sipas grup produkteve. Në bazë të këtij kategorizimi është hartuar metodologjia *"frekuenca e kontrolleve zyrtare të planifikuara me bazë risku të operatorëve të biznesit"*.

Klasifikimi i OBU-ve sipas kategorizimit të riskut (të lartë, të mesëm dhe të ulët) është bërë mbi OBU të cilët prodhojnë, përpunojnë dhe shpërndajnë ushqime me origjinë shtazore dhe jo shtazore dhe klasifikimit të riskut të ndarë sipas grup produkteve të përcaktuara , ku produktet miell dhe dritherat (prodhim/përpunim) janë pjesë e këtij kategorizimi dhe janë të përcakuara me risk U.

Kontrolllet në këto OBU kryhen sipas përzgjedhjes së skenarëve, bazuar në kategorizimin e shpjeguar më sipër, klasifikimin e tyre sipas riskut të grup produkteve, si dhe mbështetur në metodologjinë e sipërcituar sipas të cilës është përllogaritur frekuenca e përshtatshme e inspektimeve sipas skenarëve përkatës.

Niveli i riskut	Skenari A	Skenari B	Skenari C	Frekuenca e përshtatshme
L	Një herë në muaj (12 herë në vit)	Një herë në 2 muaj (6 herë në vit)	Një herë në 3 muaj (4 herë në vit)	Raporti:
M	Një herë në 3 muaj (4 herë në vit)	Një herë në 6 muaj (2 herë në vit)	Një herë në 9 muaj (1.33 herë në vit)	1L= 2 M = 6 U
U	Një herë në 6 muaj (2 herë në vit)	Një herë në 12 muaj (1 herë në vit)	Një herë në 18 muaj (0.66 herë në vit)	

Theksojmë faktin që, skenarët e përcaktuar në tabelën e mësipërme janë të ndryshëm për çdo DRAKU, pasi ato kanë numër të ndryshëm të OBU-ve, si dhe numrin e inspektorëve në dispozicion.

Pra, referuar sa shpjeguar më sipër, numri i kontrolleve në këto OBU është i ndryshëm në çdo DRAKU, pasi varion nga skenari përkatës, por duke qënë se këto produkte janë klasifikuar me risk (U), për DRAKU-të që i përkasin skenarit A kontrollet kryhen dy herë në vit (një herë në 6 muaj), për DRAKU-të që i përkasin skenarit B kontrollet kryhen një herë në 12 muaj, si dhe për DRAKU-të që i përkasin skenarit C këto kontrolle kryhen një herë në 18 muaj.

Për më tepër sqarojmë se, referuar masivitetit të konsumit dhe përdorimit që produkti "miell" ka, nga AKU janë hartuar "Plane veprimi mbi monitorimin e grurit dhe miellit në stabilimentet e blojës dhe magazinat e ruajtjes së tyre", ku objekt i tyre ka qenë:

- Kontrolli i gjurmueshmërisë;
- Kushtet e përgjithshme dhe specifike të higjienës;
- Ambalazhimi dhe etiketimi (kontrolli mbi mënyrën dhe destinacionin e përdorimit të produktit miell të deklaruar në etiketë, aditivët e përdorur në përputhje me Udhëzimin Nr. 16 datë 29.08.2011 "Për Aditivët Ushqimorë të tjerë nga ngjyruesit dhe ëmbëlsuesit", si dhe verifikimi i etiketës me treguesit e përdorur në përputhje me Udhëzimin Nr. 207 datë 31.03.2015 "Për Përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t`u shitur tek konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore;
- Dokumentacioni shoqërues;
- Marrja e mostrave sipas treguesve të sigurisë dhe cilësisë.

Në lidhje me analizat për vlerësimin cilësor të drithrave dhe produkteve të tyre sqarojmë se, kryhen në Laboratorët Rajonalë të AKU, bazuar Standardit Shqiptar : Lagështia (në %), Aciditeti i yndyrës mbi bazën e lëndës së thatë, Hiri (në %), Proteina (në %), (N x 5.7) Madhësia e grimcave në %, Gluteni i njomë, Insekte të gjalla, Papastërti, si dhe Proteina e cila analizohet vetëm në DRAKU Durrës.

Rrezet e prodhimit të këtyre produkteve, janë të ndryshme sipas llojit të miellit të përcaktuara në standardet S SH 1508-87.

Në Laboratorin e Referencës ISUV kryhen dhe analizat e sigurisë lidhur me këto produkte.

Gjithashtu, në përgjigje të pikës 7: AKU çdo vit harton *"Planin Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë risku dhe marrjes së mostrave për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore, si dhe Planin e Marrjes së Mostrave në PIK"*, (plan ky i miratuar nga Ministri i MBZHRAU), si më larë shpjeguar.

- Në lidhje me pyetjet Tuaja numër **5** dhe **6**, ku citohet:
  "6. A kryhen kontrolle te rregullta mbi miellin/drithërat për nivelin e rrezatimit?; dhe
  5. Nëse po, sa është sasia e rrezatimit tek ky miell/këto drithëra", Ju informojmë:

AKU nuk kryen kontrolle në këto produkte për nivelin e rrezatimit. Në lidhje me verifikimin radioaktivitetit të ngarkesave të importuar nga vende të veçanta pranë portit të Durrësit është i atashuar një specialist (jo nga AKU), i cili kryen verifikimet e duhura në rastet e importeve të këtyre produkteve dhe dërgon mostrat në dijenin tonë pranë institutit të fizikës Bërthamore.

Bashkëngjitur, referuar kërkesës Tuaj në pikën 8, do të gjeni raportet vjetore të kryera nga AKU për vitin 2015 dhe 2016 në hard copy.

Duke Ju uruar punë të mbarë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

DRITAN SEJKO

Adresa: Rruga "Myslym Keta", Tufine, Tirane

Tel: ++355 4 22 56 137
Fax: ++355 4 22 52 658